



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 03 qershor 2015, në mbledhjen e parë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Radisav Perović , përfaqësues i Komunitetit serb; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Sami Ajeti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Nivel komunal; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z. Bunjamin Hoti, përfaqësues i OJQ-ve; z. Fadil Halimi, përfaqësues i Mediave lokale; z. Avni Shabani, përfaqësues i Komunitetit të biznesit dhe z. Idriz Hoxha, përfaqësues i komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe u.d. i drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; znj. Antigona Qitaku Dibrani, rreshtere, përfaqësuese e Stacionit të Policisë në Podujevë; z. Milaim Ajvazi, shef i Shërbimit të Zjarrfikësve; z. Laslo Banáagi, major, shef i LMT-së; z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së; përfaqësuesi i ICITAP-it dhe përfaqësues të Zyrës së UNMIK-ut.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, ju përshëndes të gjithëve, mirë se keni ardhur, më lejoni të hapi mbledhjen e KKS-së, materialet për rendin e punës besoj se i keni marrë me kohë, a keni ndonjë sugjerim apo plotësim. Nëse jeni dakord mund të fillojmë me këtë rend pune.

1. Rend i propozuar i ditës

U miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 18 mars 2015.

z. Bunjamin Hoti, paraqiti vërejtje. Nënvizoi, në diskutimin e tij, në vend të; Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit duhet të jet Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Ekstrakti i procesverbalit me vërejtjen e paraqitur u miratua njëzëri

3. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka znj. Antigona Qitaku Dibrani, rreshter, përfaqësuese e Stacionit të Policisë në Podujevë.

znj. Antigona Qitaku Dibrani, jam ushtrues detyre e shefit të operativës në Stacionin Policor në Podujevë. Në raportin statistikor që ua dorëzova keni të dhënat në periudha të njëjta krahasuese. Në periudhën raportuese janar –prill 2015 me atë të vitit paraprak shihet ulja e numrit të rasteve prej 225.

Raporti përmban edhe periudhën e njëjtë të vitit 2012, 2013, ku tregon se numri i rasteve të paraqitura është vazhdimisht në rënie. Ky rezultat është duke iu falënderuar bashkëpunimit me qytetearë por edhe të akterëve të tjerë që kontribuojnë në gjendjen e sigurisë. Tani në sezonin veror veç e kemi përgatitur Planin operativ për sezonin veror 2015, në të cilin do të inkuadrohen plane të ndryshme. Në kuadër të planit do të hyjnë edhe koncertet e ndryshme që organizohen nëpër pishina, pastaj kemi zjarret dhe zjarrevëniet për të cilat do të implementohet edhe plani përkatës. Gjatë verës sidomos kur kemi fluks më të madh të bashkatdhetarëve kemi edhe shtimin e numrit të automjeteve dhe ne veç kemi filluar me planin Njësia me bicikleta. Problem kemi me çështjen e tërheqjes së veturave nga Kompania, pasi që para dy muajve i ka kaluar afati kontraktues, na mungon Kompania në kohën më të ngarkuar. Kërkesa është që të përshpejtohen procedurat për angazhimin e një kompanie për tërheqjen e veturave. Sa i përket zhurmave nga muzikat, në lokalet hoteliere dhe pishina, kemi filluar dhe me urdhër të Gjykatës kemi bërë dy kontrolla në dy lokale që organizojnë muzikë të gjallë, njëri pre tyre ka pas dokumentete përkatëse por që në atë lokal është konfiskuar një armë zjarri, ndërsa në lokalin tjetër kemi arrestuar dy persona të cilët kanë qenë në listën e personave të kërkuar. Ky lokal nuk posedon dokumentacion për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse dhe e veç e kemi informuar drejtorinë kompetente. Këtu sidomos gjatë ditëve të vikendit siç kanë theksuar edhe banorët kanë ndikuar në prishje të rendit. Nga qytetarët kemi pas kërkesa edhe sa i përket ndriqimit të rrugëve në disa pjesë të qytetit. Ne e dimë se në pjesën më të madhe të qytetit veç është bërë ndriqimi. Nëse bëhet diçka lidhur me këtë do të ndikonte edhe në ngritjen e sigurisë në përgjithësi, e kjo njëherit është edhe kërkesë e vazhdueshme e qytetarëve. Gjatë muajit të Ramazant do të kemi aktivitete shtesë, kjo është sa i përket raportit, nëse dikush ka diçka rreth kësaj teme, do të përpiqem të jap përgjigje.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, faleminderit, të ndëgjojmë përfaqësuesin e KFOR-it pastaj e hapim diskutimin.

z. Laslo Banásagi, major, shef i LMT-së, situata e sigurisë në dy muajtë e fundit është e qetë dhe stabile, mirëpo ende i kemi disa shqetësime. Kryetarët e Këshillave të fshatrave po ankohen sa i përket qenve endacak. Vazhdon të jet problem, sepse fëmijët e vegjël që shkojnë në shkollë frigohen nga qentë, por pasi që viti shkollorë do të përfundojë së shpejti, sigurisht që edhe kjo çështje në ndërkohë do të rregullohet. Më vjen keq që përfaqësuesi i Bashkësisë Islame nuk është këtu, mirëpo përfaqësuesja e Policisë është këtu dhe gjatë takimeve që do t'i kenë me ta do t'iu përcjell këtë, është një apel që gjatë ligjeratave dhe kohën e faljeve në Xhami, pasi që në sezonin e verës vjen edhe sezoni i dasmave, të kërkojnë prej popullatës që të kenë kujdes me vozitje dhe me krisma gjatë dasmave. E di që një shqetësim është edhe për Policinë për shkak të numrit jo të mjaftueshëm të personelit por shpresoj se së shpejti do të plotësohet me personel të ri.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, faleminderit, atëherë e hapim diskutimin nëse dikush ka ndonjë koment apo pyetje rreth raporteve.

z. Faik Muçiqi, meqenëse u parashtruan disa pyetje nga përfaqësuesi i KFOR-it dhe përfaqësuesja e Policisë, e para ka të bëjë me bllokimin e shërbimit të bartjes së automjeteve të cilës kompani i ka skaduar kontrata nga data 22 maj e jo para dy muajsh edhe këtu ka qenë në një mënyrë neglizhencë e tri institucioneve, Policisë, Menaxherit dhe Departamentit të prokurimit që nuk kanë informuar me kohë se kontrata është në skadim. Menjëherë me të marrë informacionin kam iniciuar procedurë të përshpejtuar në prokurim që të sigurojmë shërbimin e cekur. Mendoj se shumë shpejtë ky shërbim do të realizohet. Së dyti te sistemi i marimangës megjithatë të shiqohen statistikatat se del se është më pak se tri automjete të bartura gjatë ditës. Më është dorëzuar raporti megjithatë edhe pse kemi pas këtë shërbim numri i automjeteve të tërhequra është jashtzakonisht i vogël. Me kontratën e re do ta shikojmë se ku është pengesa, te menaxheri jonë, te Kompania apo te Policia.

Çështja tjetër e shtruar ishte ndriqimi në rrugë. Ne e kemi kompaninë që mirëmban ndriqimin në qytet dhe Kompania ka bërë rregullimin e ndriqimit, tani është shumë i kompletuar dhe aty ku paraqitet prishja qoftë nga qytetarët apo Policia ajo është në gjendje që në kohën sa më të shkurtër të evitojë prishjet. Është fakt se ndriqimi po dëmtohet jashtzakonisht shumë, në disa rajone edhe me qëllim, kjo i mbetet Policisë, sepse ndodhë që një rrugë të ketë vazhdimisht prishje të ndriqimit, më shpesh se sa ato normale që janë. Së shpejti fillon edhe ndriqimi solar dhe qyteti do të jet me ndriqim të plotë.

Çështjen e qenëve endacak, e kemi diskutuar disa herë këtë problematikë. Me gjithë veprimet emergjente që kemi vepruar është pakësuar numri i tyre, por siç jeni në dijeni kemi disa ligje që i kemi si pengesa në realizim të aksioneve masive të eliminimit dhe ne si Komunë jemi përballur me një kundërshtim të plotë për eliminimin masiv të qenëve, megjithatë në rastet më ekstreme

emergjente, posaqërisht afër shkollave kemi vepruar me maturi dhe nuk kemi ndonjë paraqitje ekstreme.

znj. Antigona Qitaku Dibrani, si përgjigje për parafolësin, sa i përket statistikave është e vërtetë se kur llogaritet brenda vitit rezultoni se janë tri vetura në ditë, mirëpo këtu është përfshirë edhe periudha ku thuajse ne nuk e përdorim automjetin – merimangë fare, është periudha e dimrit, ndërsa sa i përket sezonës verore minimumi i vetuarve të tërhequra në ditë janë nëntë. Sa i përket kalimit të kontratës të kompanisë për kryerjen e shërbimit të tërheqjes së automjeteve, kjo është përgjegjësi e menaxherit që mbikqyrë realizimin e kontratës që ai ta informoj organin përkatës lidhur me skadimin e kontratës. Pra s'është kompetencë e jona të kontrollojmë kontratën. Sa i përket ndriqimit në rrugë unë e pata fjalën për rrugët anësore duke filluar prej rrugës “Skënderbeu”, konkretisht te lagja e komunitetit rom edhe shkallë, ku pikërisht prej tyre kemi pas kërkesa.

z. Nexhmi Rudari, desha të falënderoj Policinë e Kosovës me rastin e menaxhimit të tri mbrëmjeve të maturave, të tri shkollave të mesme, përkundër faktit që ka pas një presion shumë të madh si nga prindërit ashtu edhe nga qytetarët tjerë. Gjithçka ka shkuar mirë. Ky vit ka qenë i veçantë sepse janë mbajtur në objektin hotelier në Podujevë.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, unë e përmbylli këtë pikë të rendit të ditës. Falënderojmë përfaqësuesen e Policisë dhe atë të KFOR-it për raportimet e bëra. Sigurisht edhe në këtë takim me kënaqësi po konstatojmë se numri i veprave kriminale të raportuara është në rënie, që është lajm i mirë. Meritat për këtë i ka edhe Policia dhe gjithë akterët sikurse që theksoi rreshterja dhe uroj që ky trend të jet vetëm në rënie. Kalojmë në pikën e radhës.

4. Përgatitjet për masat parandaluese kundër zjarrit gjatë sezonit të verës

-Informatë nga Shërbimi i Zjarrfikësve

-Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka z. Milaim Ajvazi, shef i Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit.

z. Milaim Ajvazi, theksoi, si çdo vit, edhe për këtë sezon verorë jemi në fazën e përgatitjeve teknike dhe operacionale, jemi duke bërë riparimin dhe servisimin e pajisjeve dhe automjeteve zjarrfikëse. Si masë parandaluese kemi planifikuar që nga data 01/07/15-31/08/15 të fillojmë me patrullimet e rregullta buzë Liqenit të Batllavës gjatë ditëve të vikendit për shkak të frekuentimit të madh të vizitorëve. Gjatë patrullimeve ekipet tona do të njoftojnë qytetarët dhe shitësit ambulant për masat preventive kundër zjarrit. Po ashtu edhe vizitorët do të këshillohen për një kujdes të shtuar. Sa për informim, në vitin 2013 kemi intervenuar në 429 raste, ndërsa në vitin 2014 kemi intervenuar gjithsejtë në 364 raste. Në periudhën Janar-Maj të këtij viti kemi intervenuar në 126 raste. Në bazë të këtyre statistikave shihet një rënie e lehtë e rasteve të intervenimeve.

Në bazë të raporteve të intervenimeve kemi djegie të pyjeve, fushave, hamulloreve, barit të thatë, kullotave etj. Pothuajse të gjitha zjarret shkaktohen nga vetë njerëzit dhe shumica janë zjarrvënie të qëllimshme dhe këto faktikisht në të shumtën e rasteve mbeten pa autor. Jemi të vetëdijshëm për numrin e vogël të policëve por kërkojmë një angazhim edhe më të madh të tyre në kapjen e zjarrvënësve.

Rritja e shkallës së sensibilizimit qytetar për parandalimin e zjarreve, rritja e nivelit të vrojtimit nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Komunë, organizimi i bashkërenduar i reagimit të të gjithë strukturave përgjegjëse për fikjen e zjarreve dhe zbatimi i legjislacionit në aspektin preventiv janë disa nga masat kyqe që ndikojnë në parandalimin e zjarreve.

Si masa për parandalimin e zjarreve duhet që të vazhdimisht të shpërndahen udhëzues me kërkesa të qarta si : Mos digjni mbeturinat, bari të thatë ose degë pemësh; Mos ndizni gjatë muajve të verës në pyje; Evitoni punët në natyrë të cilat eventualisht mund të shkaktojnë zjarr; Mos hidhni cigare të ndezura kur ndodheni në ambient të hapur; Mos leni mbeturina në pyll sepse ekziston mundësia e ndezjes së tyre etj. Është fat i mirë që SHZSH është pajisur me një automjet të ri nga MPB i cili shërben për fikjen e zjarreve fushore dhe pyjore dhe me një automjet tjetër i dhuruar nga Gjermania (komuna Westerstede) i cili do të na ndihmojë në raste të vërshimeve.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, për masat parandaluese kundër zjarrit nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të na informoj z. Avni Fetahu, i cili është Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe njehërit U.D. i Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

z. Avni Fetahu, fillimisht paraqiti një informatë nga Sektori i pylltarisë. Theksoi, nga ana e zyrtarve të sektorit ndaj prersve ilegal dhe transportuesve ilegal janë ngritur 201 fletëparaqitje që kapin vëllimin prej 792 metër³ dru, prej tyre 88 fletëparaqitje penale, ndërsa 113 kundërvajtse.

Si rezultat i kontrollave të zhvilluara nga ana e zyrtarve të pylltarisë si dhe nga ana e policisë (kufitare) janë konfiskuar 64.67 metër³, prej tyre 10.87 dru teknik dhe 54.00 dru zjarri.

Nga gjykatat kemi pranuar 213 aktvendime, prej të cilave 143 janë negative kurse 72 pozitive. Deri më tani kemi patur 6 raste të zjarreve të cilat kanë përfshi një sipërfaqe prej 17.80 ha. Në shuarjen e tyre kanë marrë pjesë zjarrfikësit, zyrtarët nga sektori i pylltarisë, policia dhe një numër i qytetarve. Këtu vlen të përmendet se edhe Agjencioni Pyjor i Kosovës ka të formuar një ekip i cili reagon në rastet kur ato paraqiten.

Tani, që nga dt.19.05.2015 kemi filluar edhe me lëshimin e lejeve për prerje në pyje private, mirëpo sipas Rregullores përkatëse nuk është definuar çështja e lejimit, sipas kërkesave, të prerjes së masës drusore mbi 100 m³, pra Komuna sipas rregullativës ka të lejuar lëshimin e lejeve për prerje të masës drusore nën 100 m³ përderisa paraqiten kërkesa edhe mbi 300 m³, kjo paraqet një shqetësim për Komunën. Presim që kjo çështje të definohet dhe rregullohet nga Agjencioni.

Gjithashtu një kërkesë për Policinë e Kosovës, sipas një ankese të ushtruar nga Stacioni Policor në Lluzhan, çështja ka të bëjë me një masë drusore, që ka hyrë nga jashtë territorit të Kosovës, në formë ilegale. Për ne ato duhet të konsiderohen si mall si çdo mall tjetër që hyn ilegal. Ne e kemi një shqetësim ku ata kërkojnë nga ne që ti konfiskojmë, ti marrim. Me udhëzimet aktuale që i kemi kjo nuk na lejohet për arsye se nuk mund të marrim diçka çka i takon Doganës së Kosovës apo Policisë, ndoshta kjo çështje kërkon një harmonizim më të mirë në mes Policisë dhe Doganës, që për masën drusore që është duke qëndruar që dy vite, në vende të caktuara, të bëhet ndonjë zgjidhje.

Kryetari për shkak të angazhimeve tjera autorizoi z. Nexhmi Rudarin me kryesimin e mbledhjes.

znj. Antigona Qitaku Dibrani, lidhur me çështjen e shtruar nga parafolësi, për masën drusore, sa jam e informuar ajo masë ka mbetur në mes territorit Kosovë-Serbi, si rezultat i vjedhjes së pyjeve në atë zonë, kështu që është një procedurë për tërheqjen e tyre, duke marrë për bazë territorin ku gjinden. Jam në dijeni se është duke u punuar në atë drejtim.

z. Nexhmi Rudari, falënderojmë dy përfaqësuesit për paraqitjen e informatave, megjithatë konsideroj se do të duhej fokusuar në përgatitjet për masat parandaluese të zjarreve. Ne do të duhej që së bashku të mendojmë për përgatitjen e një plani të veprimit. Shërbimi i Zjarrfikësve besoj se e ka planin, por besoj se edhe ne duke përfshirë edhe Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Policisë të bashkëveprojmë dhe ti bashkërendisimin aktivitetet qoftë në senzibilizimin e opinionit, organizimin e takimeve në pjesët e vendbanimeve ku mund të themi se në vazhdimësi ka pas zjarre, pra të zhfrytëzohen të gjitha mekanizmat, përfshirë e Këshillat e fshatrave dhe KLSB-të. Duhet theksuar se dëmet nga zjarret janë jo vetëm dëme materiale apo financiare por edhe ambientale. Në këtë aspekt do të duhej ta mbajmë një takim të veçantë dhe të shohim si mund të organizohemi më mirë.

z. Bunjamin Hoti, po ndërlidhem me diskutimin sa i përket masave që duhet të ndërmerren paraprakisht. Është e domosdoshme të ndërmerren disa masa senzibilizuese për qytetarët, në mënyrë që të informohen se djegia e hamulloreve nuk është në dobi të tokës por vetëm se ndikon negativisht në prodhimtari të kulturave bujqësore, pra nuk është në dobi por vetëm dëm. Sa i përket dëmeve nga djegiet, nuk e di se Agjencioni i Pyjeve apo Drejtoria përkatëse ka të dhëna statistikore të dëmeve pyjore të shkaktuara nga zjarret edhe sa i përket ripyllëzimit do të doja të di se a ka ndonjë plan për ripyllëzim qoftë nga Agjencioni apo Drejtoria përkatëse, ngase shumë prej atyre hapësirave kanë dështuar.

z. Avni Fetahu, statistikë të saktë për dëmet në pyje të shkaktuara nga zjarret, nuk kam por mund të siguroj në ndonjë nga takimet e ardhshme . Ne kemi filluar me disa organizata dhe donatorë që janë të gatshëm me ripyllëzuar. Tani kemi një takim me FAO-në ku si mostra mendojmë ti marrim rajonin e fshatrave Bellasicë dhe Murgullë, si raste të përshtatshme për të testuar këtë formë të ripyllëzimit dhe jemi në përpjekje për kthimin e gjendjes siç ka qenë.

z. Nexhmi Rudari, pyllëzimet që i ka bërë Agjencioni në pjesën e Kaqandollit e këtij, kryesisht në pjesën e Shalës së Bajgorës , si duket ato fidane janë të dënuara apo të destinuara të dështojnë sepse ai terren është edhe minerar por është edhe i thatë edhe i ashpër, kështu që fidanët gjasat i kanë shumë të pakta të zhvillohen, por këtu ndikojnë edhe një numër bukur i theksuar i kafshëve shtëpiake që ato hapësira i shfrytëzojnë për kullosë, të cilat edhe i dëmtojnë. Mirëpo Agjencioni i Pylltarisë , së bashku me Komunat duhet të gjejë format si të bëjë ripyllëzimin e hapësirave që tani më janë shëndrruar në kullosa

Nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

5. Senzibilizimi dhe iniciimi i aktiviteteve për parandalimin e qitjes me armë në dasma, ahengje dhe manifestime publike

z. Nexhmi Rudari, siç e theksoi rreshterja se përkundër faktit se kemi rënie të incidenteve çoftë me fatalitet apo me plagë, gjatë përdorimit të armëve të personave të paautorizuar gjatë manifestimeve apo ahengjeve të ndryshme, ne së bashku me Policinë kemi pas qe dy vite një sllogan, të festojmë me zemër e jo me armë, megjithatë ne po hyjmë në sezonin e dasmave. Fatmirësisht trendi i organizimit të dasmave ka marr një kahje më moderne, më bashkohore, nuk po festohet më nëpër shtëpi, kryesisht nëpër restorante, kështu që po zvoglohet dukshëm përdorimi i armëve, por megjithatë si traditë pothuajse në tërë Ballkanin dasmat i fillojnë me shkrepje të armës. Në këtë sens të senzibilizimit nuk mund të jetë faktor i vetëm vetëm Policia e Kosovës por edhe institucionet tjera, duke filluar nga organet komunale, shkollat, institucionet fetare, shoqëria civile, mediet lokale, që të bëjnë propagandë kudër përdorimit të armëve të zjarra.

znj. Antigona Qitaku Dibrani, veç theksova se kemi të përgatitur planin operativ sa i përket parandalimit të të shtënave me armë në dasma dhe ahengje. Është detyrë e secilit që ta senzibilizojë këtë çështje, duke filluar që në familjen e vet. Ne në Polici e kemi një rregull që kur të hasim në një armë, shkojmë me rregullin 1+ 1, bëhet kontrollimi edhe për tjetrën. Gjatë muajit të kaluar i kemi bërë 7 kontrolla nëpër lokale dhe shtëpi dhe këto kanë rezultuar pozitiv. Besojmë gjatë muajit Ramazan do të ket më pak raste pasi që pritet të ket më pak dasma, por pas përfundimit të Ramazanit pritet hov i madh i dasmave. Përfaqësuesi i KFOR-it e ceku se kemi mungesë të personelit, mirëpo duke u bazuar në statistikën që i kemi nëpër stacione do të thot se ka numër të mjaftueshëm të Policëve, por shpresojmë se së shpejti do të dal një gjeneratë e re e policëve dhe do të shtojmë numrin. Sidoqoftë në kudër të regjionit i kemi Njësitë për reagim të shpejt të cilët u përgjigjen me kohë këtyre rasteve.

z. Nexhmi Rudari, faleminderit rreshtere, nëse dikush nuk ka diçka rreth kësaj pike, kalojmë në të ndryshme.

6. Të ndryshme

znj. Antigona Qitaku Dibrani, sa i përket shkollave, ju kam informuar se muajin e kaluar ka pas incidente. Nganjëherë po rezulton konotacion tjetër raportimi i mediave me atë që ne posedojmë zyrtarisht. Kam lexuar raportin e Drejtorisë së shkollës ” Luigj Gurakuqi” sipas të cilit vijnë në një përfundim, me një emërtim çka nuk është në kompetencën e tyre, se një fëmijë- nxënës është i sëmurë dhe e ka vendin në neoropsikiatri. Kjo është shqetësuese, nisur nga fakti se personat që i takojnë këtij komuniteti na përkasin neve dhe atyre duhet tu ofrojmë mbështetjen që ata të ndihen njësoj sikurse ne, jo ti diskriminojmë apo ti emërtojmë me emra të ndryshëm çka mund të ndikojë në zhvillimin e tyre emocional. Ne e kemi Qendrën për Punë Sociale dhe vazhdimisht jemi në kontakt me të, kur kemi raste me persona të mitur. Kisha kërkuar nga Drejtoria e Arsimit të punoj në këtë kontekst sidomos në rastin e fundit edhe të dal pasqyra e vërtetë e rastit që ka qenë edhe në media.

z. Nexhmi Rudari, është fjala për një rast, për një nxënës në shkollën” Luigj Gurakuqi” në fshatin Batllavë, në paralelën e fshatit Gërdoc, i cili në vazhdimësi ka shkaktuar dëme në inventar, rrahje me nxënës deri te fyerja e mësimdhënësve. Trendi jo vetëm i arsimit në Kosovë por është trend

gjithëbotëror që nxënësit me nevoja të veçanta, përderisa nuk kanë nevoja ekstreme të jenë pjesë e mësimi të rregullt, jo të shkojnë në shkolla speciale apo në klasë të bashkangjitura. Ne e kemi një Qendër në nivel të Komunës së Podujevës ku gravitojnë të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta, për të cilët një Komision i cili është emëruar në nivel të Drejtorisë së Arsimit, nga ekspertë e vlerësojnë se është për një shkollë të këtillë, qoftë nga pamundësia që mësimdhënësi të jet i trajnuar për ti realizuar kërkesat e atij fëmije me nevoja të veçanta apo edhe për arsye të tjera, i dërgojmë në shkollë në Gllamnik. Për rastin në fjalë ne kemi pas kërkesë nga shkolla kaheër që fëmijën ta dërgojmë në një shkollë që ata e kanë quajtur speciale, mirëpo komisioni në nivel të Komunës e ka vlerësuar se ai nxënës nuk ka nevoja të theksuara që ai do të duhej të shkonte në një shkollë të tillë. Është çështje e stafit menaxherial të dijë se një fëmije që ka nevoja të veçanta por që mund ti plotësohen ato kërkesa në nivel shkolle, a dinë dhe a janë të gatshëm që ti ofrojnë më të mirën. Ne e dimë se në rast se një nxënës me nevoja të veçanta është në një klasë atëherë do të duhej të ket edhe personel shtesë, pra përveç mësuesit të rregullt duhet të ket edhe ndonjë mësues të trajnuar që të merret me fëmijun me nevojë të veçantë. Nxënësi në fjalë ka përfunduar klasën e nëntë dhe vlerësimi i Komisionit në nivel të Drejtorisë është që ai mund të vazhdojë shkollimin e mesëm të rregullt. Nevojat e tij janë më tepër të natyrës së problemeve që i ka fëmiju në familje. Mungesa e trajtimit adekuat apo ndihmës nga ana e familjes. Si duket edhe famija është në një gjendje të rëndë socio ekonomike. Siç tha rreshterja kjo më tepër është shëndërruar si çështje mediatike. U kisha bërë thirrje të jenë më të kujdesshëm në shkrimet e tyre në raport me nxënësit dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Në këtë drejtim unë si Drejtor i Arsimit nuk kam pranuar kërkesën e shkollës që atë fëmijë me e dërgue në një shkollë speciale. Siç theksoi Rreshterja mendimin për ta dërguar në një shkollë të tillë speciale mund të japin vetëm ekspertët mjekësor përkatës.

z. Liman Zeqiri, po ndërlihem me disa nga çështjet që u diskutuan për Liqenin e Batllavës, e që janë shqetësuese. Dihet që Liqeni është një pasuri e madhe kombëtare, por sa jemi duke e ruajtur këtë pasuri. Sa i përket ambientit është kompania pastrimi që merret me këtë, mirëpo probleme të mëdha janë sidomos të ndërtimeve pa leje, që edhe ne si Komunë duhet me pas qasje, pastaj problemi i i ujërave të zeza që derdhen në Liqen, e që atë ujë ne e përdorim. Ky është problem jo vetëm i nivelit lokal por edhe i instancave më të larta. Është edhe një problem tjetër, gjatë verës po përdoren pompat e ujit me rrymë, ato po futen në Liqe dhe janë të rrezikshme për shkak të elektrizimit. Në këtë kontekst duhet paralajmëruar se nuk lejohen pompat elektrike në ujë, këto gjëra duhet të jenë nën kontroll të utoriteteve. Pastaj në Liqen po bëhet edhe peshkimi i pakontrolluar. Duke parë rëndësinë dhe vlerën që ka, Liqenit duhet kushtuar kujdes të veçant, dhe kjo në ndonjë nga takimet mund të parashihet si temë.

z. Faik Muçiqi, në Liqenin e Batllavës çdo verë përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Policisë organizohen herë pas here intervenime në Liqen, aksione të përbashkëta për evitimin e mjeteve elektrike në ujë dhe sipas raportimeve këto kanë rezultuar të suksesshme disa herë, por prapë edhe këtë vit do të kemi aksione të ngjashme.

z. Naim Bajraktari, desha të kyqem në çështjen që diskutoi parafolësi, për Liqenin e Batllavës. Gjatë vlerësimit të rreziqeve që kemi bërë në rajonin e Llapit, liqeni vlerësohet dhe është një pasuri e madhe që duhet çmuar. Çështja duhet senzibilizuar edhe më lartë për faktin se ai është ujë i pijshëm dhe është një gjendje jashtzakonisht tmerruese duke marrë përbazë ujërat e zeza dhe mbeturina tjera të hedhura në të. Shtrohet pyetja se organet kompetente a kanë njohuri lidhur me këtë gjendje. Ka edhe raste kur banorë të fshatit Orllan, të frustruar për shkak se nuk kanë ujë të pijes hedhin gjëra të ndryshme në Liqen, siç janë vakra të ndryshme që janë shumë të rrezikshme. Vlerësimin që e kemi bërë në ujësjellës, në fabrikën e përpunimit të ujit proceset e filtrimit të ujit janë shumë të kushtueshme, ka një teknologji jo të avancuar por është e mirë. Uji i cili rezulton i pijshëm i mungojnë elementet më të rëndësishme, të cilat duhet ti ketë uji i pijshëm. Në këtë aspekt ne mund të pësojmë edhe deri te shfaqja e virusëve të ndryshëm. Në kuadër të kësaj është kërkesë të ndërmerret diçka më konkretisht aty. Po theksoj edhe çështjen e dezinfektimit, bazuar gjendjen e lumit, besoj se është një punë që bashkarisht mund ta ndërmarrim. Jam në dijeni për projektin e pastrimit të shtratit të lumit dhe për largimin e ujërave të zeza nga lumi, por për momentin është me urgjencë që të bëhet një dezinfektim.

z. Nexhmi Rudari, theksoi, ka qenë kërkesë e Komunës, e që kjo do të vazhdojë, që dy projekte madhore të zhvillohen dhe të zbatohen në pjesën e Liqenit. Me buxhetin që ka Komuna këtë nuk mund ta bëjë, është kanalizimi i fshatit Orllan deri te fshati Batllavë. Edhe kërkesat tona kanë qenë të

vazhdueshme që të inkuadrohet Qeveria por edhe donatorë tjerë të jashtëm siç është Komisioni Evropian apo ndonjë organizatë tjetër. Sa i përket kanalizimit dhe dezinfektimit Faiku i ka të dhënat më konkrete për planin që kemi këtë vit. Do të falënderoja FSK-në për një aktivitet që është bërë tradicional, me shkollat në Komunën e Podujevës por edhe me shkollat tjera, është fjala për organizimin e kampit veror me nxënës nga e gjithë Kosova.

z. Faik Muçiqi, ka shumë tema por unë po ndalem në atë që është në kompetencën tonë. Nuk mund të përcaktojmë se uji është i pa pijshëm apo i pijshëm, strikt dihet përgjegjësia. E dyta rreth sigurisë ne kemi problem si Komunë, Liqeni i Batllavës është aset i KEK-ut dhe i jepet në shfrytëzim Kompanisë Ujësjellësit për ujë, aty dalin edhe probleme pronësore edhe të ndërtimeve pa leje, të kanalizimit dhe probleme tjera, e mbi të gjitha siguria e digës. Ajo që kemi kërkuar është që diga të jet e sigurt, ngase kanë kaluar mbi 25 vite që nuk është bërë ndonjë studim i gjendjes së digës dhe kjo është përgjegjësi e Ministrisë përkatëse. Problemi i ujit të pijes është problem që kemi diskutuar disa herë me Kompaninë dhe me Qeverinë se nuk është i lehtë furnizimi i asaj pjese me ujë të pijes. Projekti është i kushtueshëm megjithatë Kompania dhe Komuna e kemi në prioritet.

Nga diga poshtë lumit këtë vit është në procedurë të prokurimit pastrimi dhe zgjerimi i shtratit të lumit 12 km. Kërkoj nga qytetarët që të na ndihmojnë që të mos ketë pengesa gjatë ekzekutimit të punëve, ngase ka pas raste kur vet qytetarët kanë bërë pegesa sa i përket zgjerimit të shtratit të lumit. Mendoj se pas zgjerimit të shtratit të lumit do të ketë dezinfektim. Vitin e ardhshëm do të fillojmë prej lagjes së Boshnjakëve me kolektor. Pra do të punohet me zgjerim të shtratit, ndërtim të kolektorit dhe mbylljen e kanalizimeve nën digë, ndërsa mbi digë do të jetë problem thjesht qeveritar, për shkak të kostonë së lartë.

z. Liman Zeqiri, ne jemi në dijeni për kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve, por fjala është që ne si Këshill, grup apo Komunë me ngritë shqetësimin tonë, që për këtë me u marrë organet më kompetente, që mos të jetë vetëm si temë e hapur, por ta ngritim si shqetësim edhe në instanca më të larta. Ky ishte qëllimi im, ngase ne të gjithë jemi në dijeni se Liqeni me të vërtetë është duke u shkatërruar.

z. Nexhmi Rudari, mund të shtoj se pavarësisht se si mund të bëhet ndarja e kompetencave, qytetari si të vetmen adresë për kryerje të shërbimeve e njeh Komunën. Konsideroj se gjithçka që ka të bëjë me sigurinë e qytetarëve tonë është temë legale që ne duhet ta diskutojmë dhe ta ngritim zërin, pavarësisht se kompetencë e kujt do të jetë. Nënkryetari në vazhdim foli nevojën dhe mundësitë e ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në fshatin Orllan. Nënvizoi, për shkak të kostonë së lartë, kërkesat e Komunës për implementimin e këtij projekti do të jenë në vazhdimësi.

Kryesuesi përfundoi mbledhjen pasi që nuk pat çështje tjera për shqyrtim, ndërsa të pranishmit në emër të Kryetarit të Komunës i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 11.15

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-006-56794

Podujevë,

03 qershor 2015

Kryetari i Komunës

Agim Veliu